

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, sekretarja juridike Violeta Zeqiri, në lëndën penale kundër të akuzuarve M.S., L.S., H.S. dhe A.S., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.365/1/13 të datës 10.06.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me 21.01.2016 në prezentë të prokurorit të shtetit Veton Shabani, i akuzuari shpall dhe publikisht komunikon, ndërsa përpilimi me shkrim i këtij aktgjykimi u bë me datën 29.01.2016 dhe u mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Kundër të akuzuarve:

1. **M.S.**, nga fshati ..... Komuna Ferizaj, data e lindjes....., nga i ati S. e ëma F. e gjinisë S., i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës
2. **L.S.**, nga fshati ..... Komuna Ferizaj, data e lindjes....., nga i ati A. e ëma Z. e gjinisë S., me profesion frizer, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës
3. **H.S.**, nga fshati ..... Komuna Ferizaj, data e lindjes....., nga i ati R. e ëma F. e gjinisë H., i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion instruktor i auto shkollës, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

4. **A.S.**, nga fshati ..... Komuna Ferizaj, data e lindjes....., nga i ati I. e ëma S. e gjinisë M., i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion kopshtar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

### **Është fajtorë**

Se me datën 16.02.2013 rreth orës 18:00 ne rr.”Tahir Sinani” në Ferizaj i kane shkaktuar lëndime trupore te dëmtuarit P.Z. ne atë mënyrë qe për shkak te një mosmarrëveshje familjare, derisa i dëmtuari ka qene duke ecur rrugës ne mënyre te befasishme ne bashkëkryerje nga mbrapa e sulmojnë fizikisht duke e goditur me mjete te forta shufër metali dhe kaçavidë, mjete këto të përshtatshme për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor duke e goditur disa herë kokë shpinë dhe në pjesë të ndryshme te trupit me ç ‘rast i shkakton lëndime trupore,-

**me të cilën kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së**

**Andaj gjykata ne baze të neneve 4,7,17,21,41,46 dhe 73 të KPRK-së si dhe neni 365 të KPPK-së,**

### **GJYKON**

**Të akuzuarit M.S. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/muaj i cili konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 600 /gjashtëqind / € të cilit i lejohet që ta paguaj me këste mujore në afat prej 2/dy /muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi**

**Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 4 të KPRK-së, i njëjti do te vuaj dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.**

**Të akuzuarit L.S. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5/pesë/muaj i cili konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 800 /tetëqind/ € të cilit i lejohet që ta paguaj me këste mujore në afat prej 3/tre/muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi**

**Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 4 të KPRK-së, i njëjti do te vuaj dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj.**

**Të akuzuarit A.S. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/muaj i cili konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 600 /gjashtëqind / € të cilit i lejohet që ta paguaj me këste mujore në afat prej 2/dy /muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi**

**Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 4 të KPRK-së, i njëjti do te vuaj dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.**

**I dëmtuari, P.Z. nga fshati ..... Komuna e Viti për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.**

**Obligohen të akuzuarit M.S., L.S. dhe A.S. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 20,44/ njëzetë euro e dyzetë e katër cent/€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën me nga 30 /tridhjetë/ € në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.**

**Në bazë të nenit 363 par. 1 nën par.1.1 të KPPK-së,**

## **REFUZOHET AKUZA**

**II. Refuzohet akuza për të akuzuarin e tretë H.S.** se me datën 16.02.2013 rreth orës 18:00 ne rr.”Tahir Sinani” në Ferizaj i kane shkaktuar lëndime trupore te dëmtuarit P.Z. ne atë mënyrë qe për shkak te një mosmarrëveshje familjare, derisa i dëmtuari ka qene duke ecur rrugës ne mënyre te befasishme ne bashkëkryerje nga mbrapa e sulmojnë fizikisht duke e goditur me mjete te forta shufër metalit dhe kaçavidë, mjete këto të përshtatshme për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor duke e goditur disa herë kokë shpinë dhe në pjesë të ndryshme te trupit me ç ‘rast i shkaktonte lëndime trupore,

Pasi që prokurori i shtetit tërhiqet nga ndjekja penale dhe nga aktakuza për të akuzuarin H.S. ngase nga provat e administruara nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë se i njëjti ka qenë prezent në ditën kritike dhe se e ka sulmuar të dëmtuarin P.Z..

### **Arsyetimi**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë të evidentuar Ferizaj PP/II.nr.365-1/13 të datës 10.06.2013, ka akuzuar M.S., L. S. dhe A.S., për veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 17.11.2015, në të cilën shqyrtim të akuzuarit 1. M.S. është deklaruar fajtor për veprën për të cilën i ngarkon akuza duke shprehur pendim të thellë dhe te sigurtë për lëndimet që i kanë shkaktuar të dëmtuarit, lusin gjykatën që t’iu shqiptoj një dënim sa më të butë. Gjithashtu ka potencuar se ka qenë i provokuar nga i dëmtuarit dhe frikën që ia ka shkaktuar L.S. është ndjerë i detyruar që të shkoj në vendin e ngjarjes dhe të ballafaqohet me të dëmtuarin. 2 A.S. është deklaruar fajtor për veprën për të cilën i ngarkon akuza duke shprehur pendim të thellë dhe te sigurtë për lëndimet që i kanë shkaktuar të dëmtuarit, lusin gjykatën që t’iu shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pasi që të akuzuarit M.S. dhe A.S. kanë pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: mendimi i ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. N.U. e dt. 13.04.2013, deklarata e të akuzuarve, deklarata e të dëmtuarit, raporti mjekësor nga Qendra Spitalore në Ferizaj e dt. 16.02.2013, raporti mbi kontrollimin RO si dhe fotografitë të cilat gjenden ne shkresat e lëndës.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me datën 21.01.2016 në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit Veton Shabani, deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptohet dënim i paraparë sipas ligjit, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së.

I akuzuari L.S., në fillim të shqyrtimit fillestar dhe në të gjitha fazat e procedurës penale po ashtu dhe ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë, po ashtu edhe në mbrojtjen e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk është e vërtet se ka kryer veprën penale në fjalë, sepse në ditën kritike nuk ka qenë në vendin e ngjarjes duke shtuar se pas një telefonate që ka marrë nga i akuzuari M.S. ka shkuar në vendin e ngjarjes mbrapa teatrit në Ferizaj pasi që kishte ndodh ngjarja me të dëmtuarin P.Z. i njëjti është takuar me M.S. dhe A.S. duke potencuar se të dëmtuarin e ka parë duke qëndruar në këmbë, në ato momente e kishte marrë M.S. dhe ka vazhduar rrugën për në shtëpi.

Gjykata ka bërë prezantimin e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën konform nenit 387 par. 1 të KPPK-ës, vërtetohet gjendjen faktike si që është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit P.Z. dhe dëshmia e dëshmitarëve F.H. dhe B.I., mendimi i ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. N.U. e dt. 13.04.2013, deklarata e të akuzuarve, deklarata e të dëmtuarit, raporti mjekësor nga Qendra Spitalore në Ferizaj e dt. 16.02.2013, raporti mbi kontrollimin RO si dhe fotografitë të cilat gjenden ne shkresat e lëndës.

Nga dhënia e dëshmisë së dëshmitarit- të dëmtuarit P.Z., ka vërtetuar se me të akuzuarit ka qenë miq i cili kishte qenë i martuar afër dy vite me G.S., por pasi që i njëjti është ndarë nga bashkëshortja e tij – G.S. afërsisht 4 vite më parë duke shtuar se me datën 16.02.2013 kishte qenë në teatër ku para shfaqjes kishte qenë në kafiteri në të cilën kishin qenë edhe M.S. me një person tjetër i cili i ka ngjasuar me H.S. por nuk ishte i sigurt pasi që të njëjtit i kishte vërejtur menjëherë kishte dal jashtë dhe kishte shkuar në teatër, duke qëndruar 10-15 minuta duke shtuar se ne ditën kritike ka qenë me dy kolegët e tij rreth orës 6 në mbrëmje dhe se aty ka qenë gjithashtu edhe M.S. A.S. dhe L.S. ku potencon se ka pasur edhe persona tjerë por nuk ka mund t'i identifikoj, sa i përket identifikimit për L.S. dëshmitari- i dëmtuari ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë edhe L.S. dhe me ka goditur me një shufër- mjet i fort nga ana e mbrapme. Ndërsa sa i përket të akuzuarit H.S. i dëmtuari- dëshmitari ka deklaruar se nuk është i sigurt se ka qenë edhe i akuzuari H.S. por e di që kanë qenë edhe disa persona tjerë përpos M.S. A.S. dhe L.S.. Dhe shton se përlëshja ka zgjatur afërsisht 5 minuta, ku në ato momente nuk i kujtohet se si janë larguar të akuzuarit por potencon se dikush e ka lajmëruar policinë pastaj të akuzuarit kishin ikur.

Nga dhënia e dëshmisë së dëshmitarit F.H., ka deklaruar se në ditën kritike së bashku me të dëmtuarin P.Z. para shfaqjes kanë qenë ne një kafiteri ku aty janë takuar me kryesuesin e projektit të shfaqjes A.K.. Pasi shfaqjes ka dalë së bashku me P.Z. dhe B.I. mbrapa teatrit ku në ato momente i kishin sulmuar disa persona, ku potencon se B.I. më nuk e ka parë por atë e kishte shoqëruar një person deri te rruga ku aty kishte vërejtur disa goditje që i kanë bërë P.Z. duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit me shufra metalike dhe kanë qenë diku 4-5 persona ku ato shufra kanë qenë mjet i fortë. Sa i përket identifikimit për L.S. dhe H.S. dëshmitarit ka potencuar se nuk ka mund ta vërej pasi që ka qenë me një largësi me të akuzuarit.

Dëshmitari i propozuar nga ana e të akuzuarit B.I. në dëshminë e tij ka deklaruar se në ditën kritike para shfaqjes në teatër së bashku me P.Z. ka qenë në një kafieri përballë teatrit i cili nuk ka qenë në dijeni për raportet e P.Z. me të akuzuarit por vetëm kanë biseduar rreth profesionit të tyre. Pasi e kanë mbajtur shfaqjen kanë vazhduar me P.Z. mbrapa teatrit dhe me kolegun F.H. ku kanë vazhduar rrugën për në shtëpi kurse kolegu P.Z. ka qenë i interesuar që të gjej një taksì për të shkuar të dajit e tij ku ne ato momente ka vërejtur disa persona që papritmas i ka dëgjuar duke e goditur P.Z. me shufra te hekurit dhe duke shtuar se afërsisht kanë qenë 7-10 persona që e kanë goditur mirëpo nuk ka mund ti identifikoj se sa persona kanë qenë saktësisht. Sa i përket identifikimit të akuzuarve të cilët gjendeshin në sallë të gjyqimit dëshmitari ka deklaruar se nuk me kujtohen por vetëm ka deklaruar se njëri prej tyre ka qenë me mjekër të bardhë, duke shtuar se me P.Z. jemi takuar më vonë në spital dhe në stacionin policor.

Gjykata dëshminë e këtyre dëshmitarëve e ka vlerësuar si dëshmi objektive dhe te cilat dëshmi janë provuar edhe me provat tjera materiale.

Gjykata këtyre provave materiale dhe dëshmisë së dëshmitarëve P.Z., F.H. dhe B.I. u fali besim të plotë dhe si të tilla i konsideroj si të besueshme.

Gjykata ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit janë prezentë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së, se të akuzuarit me dashje direkte i kanë shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit P.Z..

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se të akuzuarit M.S. ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, pasi që i njëjti është baba i pesë fëmijëve i, përkatësisht mbajtës i familjes, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, në shqyrtimin fillestar, i akuzuari A.S. ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, pasi që i njëjti është baba i tre fëmijëve, përkatësisht mbajtës i familjes, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, në shqyrtimin fillestar në rastin konkret

nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale. *Gjykata të akuzuarve M.S. dhe A.S. iu shqiptoj dënim burgimi në kohëzgjatje me nga 3 /tre/ muaj dhe këtë dënim gjykata me pëlqimin e të akuzuarve konform nenit 47 të KPRK-së e zëvendësoi me dënim me gjobë, kurse lartësia e këtij dënimi nga burgu më gjobë në lartësi me nga 600/ gjashtëqind/€ i cili është caktuar konform nenit 46 par.1 të KPRK-së.*

Për të akuzuarin L.S. gjykata si rrethana lehtësuese vlerësoj pasi që i njëjti është i moshës së re, mbajtës i familjes respektivisht mbajtës i 8 anëtareve të familjes, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përveç që vlerësoj rrethanat në të cilat ka ndodhur ngjarja dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale. *Gjykata të akuzuarit L. S. i shqiptoj dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 /pesë/ muaj dhe këtë dënim gjykata me pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 47 të KPRK-së e zëvendësoi me dënim me gjobë, kurse lartësia e këtij dënimi nga burgu më gjobë në lartësi prej 800/ tetëqind/ €, i cili është caktuar konform nenit 46 par.1 të KPRK-së.*

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit përkatësisht qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës, dhe me këtë dënim të shqiptuar që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve rrethanat e kryerjes si dhe personalitetin e tyre se edhe me anë të këtyre dënimeve do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale.

I dëmtuari, P.Z. nga fshati ..... Komuna e Viti për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konformë nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohen të akuzuarit M.S., L.S. dhe A.S. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 20.44/ njëzetë euro e dyzetë e katër cent/€ si dhe në emër të paushallit



gjqësor të paguajnë secili veç e veç shumën me nga 30 /tridhjetë/ € në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e lartëcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.1059/13 me datë 29.01.2016**

**Sekretare juridike,**

Violeta Zeqiri

**Gjyqtarja Individuale,**

Hakile ILAZI

**Këshilla juridike:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh. Kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.